



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

28 Shkurt 2022

RAPORT I VEÇANTË MONITORIMI

“Për cenimin e të drejtës së jetës private dhe standarteve të procesit të rregullt ligjor, si rezultat i prishjes nga IKMT të një objekti banimi në zonën e Jalës”

Fillimi i Verifikimit

Në përputhje me misionin e tij për garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në mënyrë sporadike realizon misione verifikimi në terren, bazuar në ankesat e qytetarëve apo informacionit të publikuar në media.

Nisur nga ankesa e adresuar nga ana e qytetares E.B.¹, banuese në Jalë, Bashkia Himarë, ekipi i vëzhguesve të KShH-së udhëtoi drejt vendbanimit të ankueses, më datë 7 Tetor 2021. Ankuesja referoi se prej 2 ditësh², nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) janë ndërmarrë aksione për prishjen e banesës së saj dhe të familjarëve të tjerë. Momenti i prishjes së banesave publikuar në media të ndryshme është shoqëruar me tensione ndërmjet qytetarëve dhe inspektorëve të IKMT-së. Qytetarët pretenduan se shembja e banesave po realizohet në mënyrë të paligjshme, në mungesë të një vendimmarrje gjyqësore përfundimtare (të formës së prerë) dhe në cënim të procedurave të rregullta ligjore.

Informacioni fillestar i marrë nga vëzhguesit me anë të verifikimit të situatës në terren, intervistimit të banorëve, bashkëbisedimit me përfaqësues të institucioneve shtetërore nuk ka qenë i mjaftueshëm për të konkluduar mbi shkeljet e referuara.

Në vijimësi, KShH ka ndeshur në vështirësi për shkak të mosfrimit në kohë të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar në rrugë zyrtare nga IKMT, sa i takon procedurave të ndjekura dhe bazueshmërisë së tyre në ligj.

Kronologjia e fakteve të çështjes së verifikuar

1. Më datë 09.07.2020, Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Himarë (IVMT) ka kryer një kontroll në pasurinë e subjektit fizik, gjatë të cilit ka konstatuar (në mungesë të banorëve) kryerjen e punimeve pa leje, përkatësisht një objekt me konstrukcion druri me sipërfaqe rreth 50 m². Në vijim të inspektimit, IVMT ka dhënë vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe dënimin me gjobë të subjektit, i cili është njohur me këtë vendim me anë të postës, por jo me procesverbalin e konstatimit të shkeljes. Duke pretenduar se këto vendimmarrje kanë qenë të kundërligjshme, qytetari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Në dt. 10.03.2021, kjo gjykatë ka shqyrtuar çështjen në fjalë, me objekt “Shfuqizimin e akteve administrative vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe vendimin për dënim me gjobë ndaj paditësit F.B.”. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë padisë duke argumentuar se para saj nuk është argumentuar

¹ Ankesa është adresuar në rrugë telefonike nga ana e qytetares më dt. 4 Tetor 2021.

² <https://ëëë.syri.net/kronike/454523/video-syri-tv-shemben-banesa-ne-jale-lihet-ne-qiell-te-hapur-familja-shteti-po-na-grabit/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kundër ligjshmëria nga ana e IVMT. Bashkia Himarë ka ankimuar këtë vendim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Aktualisht çështja është në shqyrtim pranë kësaj Gjykate.

2. Banorët kanë ndërhyrë në rrënojat e objektit të prishur duke përshtatur pjesën e mbetur nëpërmjet llamarinave duke e shndërruar në një restorant provizor. Sipas ankueses, më datë 04.10.2021 janë rikthyer përfaqësuesit e IKMT dhe kanë vijuar prishjen, duke u justifikuar fillimisht se po hiqnin inertet e ndërtimit të prishur më herët por sipas saj, krahas heqjes së inerteve të mbetura në vend nga prishja e objektit të parë, i konstatuar në datë 09.07.2020, nga IVMT pranë Bashkisë Himarë kanë vijuar që të shtrijnë procesin e prishjes edhe në pjesë të tjera a të pasurisë, konkretisht duke prishur shtëpinë ku banonte ankuesja E.B dhe bashkëshorti i saj F.B.

3. Me datë 05.10.2021 në terren është shfaqur një inspektor, i cili ka kërkuar që ankuesja të firmosë një procesverbal. Ankuesja nuk pranon nënshkrimin e dokumentit të titulluar “Njoftim” me datë 04.09.2021, për shkak se ky njoftim po i jepet një muaj më vonë, përkatësisht në dt. 05.10.2021. Me datë 06.10.2021 palës i është lënë fizikisht nga ana e një inspektori vendimi nr.210, datë 29.09.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, objekt 1 kat me gurë, i mbuluar me tjegulla, pa leje ndërtimi. Kjo ndërtesë ka qenë shtëpi banimi e ankueses E.B.

4. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga familjari i ankueses, shtetasi A.B., u konstatua se prona objekt prishjeje rezultonte e regjistruar në regjistrin hipotekor në pronësi të babait të ankuesit H.B. Ky pretendim provohej duke u bazuar në vërtetimin e pronësisë³, listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore⁴, dhe vërtetimin e Kryesisë së fshatit.⁵ **Këto akte nuk rezultojnë të jenë regjistruar pranë organeve të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht zyra kadastrale) dhe as nuk i janë nënshtruar procedurave të mëtejshme ligjore nga ana e ankuesve, me synim regjistrimin e pronës në emrin e tyre dhe disponimin e certifikatës së regjistrimit të pronësisë.**

5. Kjo pasuri e paluajtshme rezultojnë e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht ‘Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve’ Nga vërtetimi i ZVRPP Vlorë rezultojnë se në regjistrin hipotekor nr. 231, dt. 29.06.2016 figuron e regjistruar në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes pasuria me numër 970/1, e ndodhur në zonën kadastrale 3844 me sipërfaqe 44481 m².⁶ Gjithashtu, ankuesi ka vënë në dispozicion të ekipit të vëzhguesve të KShH-së:

³ Lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Rrethit Vlorë (në vijim ZVRPP Vlorë) më datë 15.06.2007 vërtetoi se në regjistrin hipotekor me nr. 021, datë 22.05.1992 figuron e regjistruar në pronësi të H.B. pasuria që ndodhet në zonën kadastrale 3844 me sipërfaqe 1750 m².

⁴ Ky dokument i lëshuar nga kryetari dhe sekretari i këshillit bashkiak, Bashkia Himarë përcakton si përdorues faktikë të tokës bujqësore F.B. dhe R.B.

⁵ Ky dokument i përket datës 02.10.2021, nxjerrë nga Kryesia e Fshatit Vuno, në të cilin vërtetohet se Z. H.M. në vitin 1993 ka blerë nga ushtria dy ndërtesa, njëra me sipërfaqe rreth 150 m² dhe tjetra me sipërfaqe rreth 30 m², të cilat më pas janë përshtatur si shtëpi banimi. Aktualisht në këto shtëpi banojnë H.B dhe F.B.

⁶ Vërtetimi i pronësisë është lëshuar nga ana e ZVRPP Vlorë, në bazë të kërkesës së datës 22.04.2016.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- *Njoftim për lirim prone* – i përket datës 28.09.2016, me Nr. Regj. 3331, me anë të të cilit Reparti Ushtarak Nr. 6630 i është drejtuar Z. H.B. me kërkesë për lirin fizik të pronës brenda datës 12.10.2016.
- *Kërkesë për lirim prone* – i përket datës 30.09.2016, me Nr. Prot. 3865, me anë të të cilës Komanda e Forcës Detare i është drejtuar Z. H.B. me kërkesë për lirin e pronës me sipërfaqe prej 71.7 m² brenda datës 14.10.2016.
Referuar shkresave sa më sipër, ankuesi nuk ka liruuar pronën dhe ka vijuar qëndrimin në të.
- *Kërkesë për bashkëpunim* – i përket datës 07.08.2018, me Nr. Prot. 6065/1, me anë të të cilës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, i ka kërkuar ALUIZNI-t dhe IKMT-së skualifikimin e objekteve në proces legalizimi të ndërtuara në pronën Nr. 970/1, si dhe marrjen e masave përkatëse ligjore për lirin e hapësirës së zënë nga këto objekte.



6. Në momentin e marrjes së veprimeve aktive për prishjen e banesës më dt. 04.10.2021, ankuesja pretendon se asnjë nga inspektorët e pranishëm në terren nuk është identifikuar. Qytetarët kanë arritur të identifikojnë prezencën e tyre si përfaqësues të IKMT-së vetëm mbi bazën e uniformave që mbanin veshur.

➤ *Takim me përfaqësuesit e IKMT në terren, IVMT Himarë dhe Bashkisë Himarë*

7. Gjatë realizimit të monitorimit në terren, vëzhguesit e KShH-së kërkuar të bashkëbisedonin me 4 inspektorë të IKMT-së, por prej tyre u refuzua intervistimi, me argumentimin se ata ishin punonjës ekzekutues të vendimmarrjeve të eprorëve të tyre. Gjatë komunikimeve verbale kontradiktore të realizuara nga 2 inspektorët,⁷ grupi i vëzhgimit e pati të pamundur të aksesonte informacionin për procedurën e ndërmarrë dhe legjitimitetin e saj.

Në pamundësi për të realizuar takim fizikisht me kryeinspektorin e IVMT-së, në lidhje telefonike na u bë me dije se procesi i prishjes së këtyre banesave është një proces i ndërmarrë nga ana e IKMT-së në nivel qendror. Ndërkohë vendimmarrja për prishjen e objektit në vitin 2020, është shfuqizuar nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, dhe momentalisht ankimi i kësaj vendimmarrje pritet të shqyrtohet në Gjykatën Administrative të Apelit. Bazuar tek neni 14 paragrafi i dytë i ligjit nr. 9780/2007 ankimi gjyqësor kundër vendimit të IKMT-së dhe IVMT-së nuk pezullon ekzekutimin e tij. Diçka e tillë mund të ndodhë nëse palët veprojnë sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit 49/2012 duke kërkuar sigurimin e padisë çka do të sillte pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ, nëse gjykata do të pranonte kërkesën.

8. Përfaqësuesi i Bashkisë Himarë, bëri me dije në rrugë telefonike, kompetencën e tij për të përfaqësuar institucionin vetëm në proceset gjyqësore, ndërkohë lidhur me këtë procedurë ai u shpreh se nuk kishte qenë pjesë e shqyrtimit të saj.

⁷ Në terren, njëri prej inspektorëve spjegoi në mënyrë të përmbledhur se po hiqnin inertet e prishjes së parë, atë të vitit 2020 ndërsa një tjetër inspektor u shpreh se po zbatonin disa vendime të reja të organeve kompetente dhe se për këto veprime kishte dijeni edhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

✚ Ndërhyrjet institucionale të realizuara nga KShH

9. Me synim verifikimin e ankesës duke u mbështetur në disa burime informacioni, KShH ka përcjellë 2 shkresa zyrtare pranë IKMT-së. Nëpërmjet shkresës nr. 663, prot., dt. 6 Tetor 2021, KShH i ka përcjellë IKMT-së ankesën e qytetares, si dhe ka kërkuar të informohet mbi procedurat e ndjekura prej këtij institucioni për ekzekutimin e vendimmarrjes së prishjes së objektit. Gjithashtu, KShH ka kërkuar nga ana e institucionit vënien në dispozicion të një kopjeje të praktikës dokumentative të mbajtur nga institucioni për këtë çështje.

Me shkresën zyrtare nr. 733 prot datë 28.10.2021, IKMT informon KShH-në në mënyrë të përgjithshme dhe jo të plotë, për situatën që kishte shtyrë këtë institucion për të ndërmarrë aksionin përkatës për prishjen e banesave të ankueses dhe familjarëve të saj. Referuar kësaj shkrese: *“Nga grupi i inspektimit, u konstatuan 2 ndërtime të ndërtuara në kundërshtim me ligjin. Për sa më sipër, në kushtet kur nga inspektorët e IKMT është konstatuar kundërvajtja e sipërcituar, e parashikuar në ligj, në respektim të procedurës, detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave është vazhduar me procedurat e mëtejshme ligjore, duke dalë me vendimin përkatës. Pas verifikimit të kryer në sektorin e Arkiv-Protokollit pranë IKMT nuk është gjendur asnjë procedurë e mbajtur në emrin e Znj. E.B.”*

10. Duke vlerësuar këtë përgjigje si jo të plotë, KShH iu drejtua IKMT-së në nivel qendror me një shkresë të dytë, nr. 752 prot. datë 5 Nëntor 2021, me anë të së cilës u kërkuar akses në dokumentacionin e plotë për procedurën, mbi ekzekutimin e vendimit nr. 210, dt. 29.09.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”. Me shkresën nr. 850 prot datë 03.12.2021, IKMT ka përcjellë procedurën e ndjekur nga IKMT mbi ekzekutimin e kësaj vendimmarrje⁸.

Analiza ligjore, mbështetur në kuadrin ligjor vendas

11. Mbështetur në nenin 12 pika 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, është parashikuar detyrimi i pasqyrimin të gjendjes së konstatuar gjatë kontrollit, në procesverbalin përkatës të konstatimit, si dhe nënshkrimin nga ana e kryeinspektorit/inspektorit që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Gjithashtu, në ligj parashikohet edhe detyrimi i autoritetit publik për t’i dhënë subjektit të kontrolluar një kopje të procesverbalit të konstatimit. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Por pavarësisht mosprezencës së subjektit, bazuar në pikën 6 të nenit 12, subjektit duhet t’i vihet në dispozicion brenda 5 ditëve nga data e kontrollit, kopje e procesverbalit të konstatimit.

⁸ Më konkretisht praktika e dokumentave të përcjellë përmban: procesverbalin “Për konstatimin e kundërvajtjes nr. 08, datë 27.09.2021”; vendimin nr. 210, datë 29.09.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, foto të objektit të konsideruar të ndërtuar në mënyrë të paligjshme, si dhe procesverbalin e ekzekutimit të datës 06.10.2021.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

12. Në analizë të procesverbalit “Për konstatimin e kundërvajtjes nr. 08, datë 27.09.2021”, rezulton se subjekti i kontrolluar nuk ka nënshkruar. Bashkëlidhur praktikës nuk rezulton të jetë përcjellë asnjë dokument i cili të jetë hartuar me qëllim respektimin e përcaktimit të nenit 12 pika 6 të ligjit. Në mungesë të këtij dokumentacioni, mbetet jo e provuar nga ana e autoritetit publik që subjektin të kontrolluar, t’i jetë përcjellë procesverbali përkatës për nënshkrim.

13. Referuar ligjit nr.9780 të vitit 2007, sipas nenit 17, pika 7 të tij, nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Në procesverbal, grupi i kontrollit referon se subjekti juridik/fizik është i paidentifikuar. Vëzhguesit e KShH-së, të cilët morën takim në terren edhe me të tjerë banorë të zonës, e vlerësojnë si të pambështetur këtë cilësim, pasi fakti që banesa dhe pasuria e paluajtshme e përdorur në perimetrin e territorit të Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve Jalë, është një fakt i njohur publikisht se është në përdorim të shtetasit A.B dhe familjarëve të tij. Mgjith, edhe nëse do të merrej e mirëqenë që subjekti ishte i paidentifikuar, nuk rezulton i provueshëm nga IKMT afishimi i këtij procesverbali në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit.

14. Kjo procedurë e autoritetit publik (IKMT) konstatohet se ka cënuar të drejtën e ankimit të palës së dëmtuar, për të kërkuar sigurimin e padisë në gjykatë dhe rrjedhimisht edhe pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ. Duke u bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 9780/2007, vendimmarrja e IKMT-së dhe ajo e njësisë vendore mund të ankimohet në Gjykatë brenda afatit 10 ditor, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Vëzhguesit e KShH-së vlerësojnë se thjesht lënia në dyert e objektit, të kopjes së procesverbalit të konstatimit dhe mungesa e provueshmërisë së këtij fakti nga IKMT, bien në kundërshtim me procedurat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9780/2007. Gjithashtu, qytetares i është vënë në dispozicion nga ana e inspektorëve të IKMT-së, vendimi 29.09.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, në format kopje dhe jo origjinal, duke pamundësuar ankimin e këtij vendimi në format fotokopje në gjykatë. Ky është një element tjetër që ka cënuar aksesin e qytetares në organet e drejtësisë.

Standartet ndërkombëtare

Gjithashtu, vëzhguesit e KShH-së kanë analizuar faktet e kësaj çështjeje, në raport me standartet ndërkombëtare dhe garancinë e respektimit të së drejtës së pronës, shtëpisë dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të ankuases.

Në nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) parashikohet se: “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij.” Në interpretim të nenit 8 të Konventës, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e ka analizuar nocionin “shtëpi” si një koncept autonom i cili nuk varet nga klasifikimi sipas ligjit të brendshëm (*Chiragov dhe të tjerët kundër Armenisë* [GC], § 206). Pavarësisht faktit nëq qytetari është pronar ose qiramarrës, Gjykata e ka shtrirë këtë përkufizim duke u bazuar në banimin afatgjatë në një vend të caktuar, në baza vjetore,



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

për periudha të gjata, edhe në rast se banesa i përket një të afërmi në pronësi (*Menteş dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 73).⁹

Neni 8 i KEDNJ-së nuk ka karakter absolut. Sipas paragrafit 2 të kësaj dispozite, autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerë. Në rastin objekt shqyrtimi ndërhyrja nga ana e autoritetit publik në tejkalim të procedurës ligjore nuk mund të cilësohet si një shkallë e parashikuar në ligj. Vetë Gjykata e Strasburgut e ka njohur se: “...shkatërrimin e qëllimshëm të shtëpisë nga autoritetet¹⁰ ose konfiskimi¹¹, si një formë e ndërhyrjes së mundshme të autoriteteve publike në ushtrimin e kësaj të drejte.”

Referuar çështjeve *Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 82; *Gladysheva kundër Rusisë*, §§ 91-96, GJEDNJ ka vlerësuar se kufiri i vlerësimit për ndërhyrje nga ana e shtetit në çështjet e strehimit është më i kufizuar kur ka të bëjë me të drejtat e garantuara nga neni 8, në krahasim me ato në nenin 1 të protokollit nr. 1 (§ 93 ibid). Në çështjen *Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, GJEDNJ ka argumentuar se e drejta për respektimin e shtëpisë sipas nenit 8 të Konventës, përfshin çështje me “rëndësi thelbësore për fizikun dhe moralin e individit, integritetin, ruajtjen e marrëdhënieve me të tjerët dhe një vend të vendosur dhe të sigurt në komunitet”. Gjatë trajtimit dhe kontaktit me banorët, vëzhguesit kanë konstatuar se gjendja emocionale dhe psikologjike e ankueses dhe familjarëve të saj (ndër të tjerash të moshuar) ka qenë e rënduar.

Zbatimi i nenit 1 protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili ofron garanci për të drejtat e banimit në një pronë që nuk është pronësi legjitime e aplikantit, është konsideruar nga ana e GJEDNJ-së. Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ ka vërejtur se posedimi i vazhdueshëm nga ana e qytetares dhe familjarëve të saj për më shumë se 20 vite¹², ka krijuar karakterin e mirëbesimit si dhe është shoqëruar me tolerancën e dukshme të autoriteteve publike.¹³ Sipas praktikës së GJEDNJ humbja e shtëpisë së dikujt është forma më ekstreme e ndërhyrjes në të drejtën e respektimit të “shtëpisë” (*Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, §§ 52-54). Gjykata e zgjeroi mbrojtjen që parashikon neni 8 edhe për person që kishte jetuar në mënyrë të paligjshme në banesën e saj për gati 40 vjet. (*Brežec kundër Kroacisë*, § 36).

Në rastin e ankueses, disponimi i kësaj prone në mënyrë të qetë nga ana e saj dhe e familjarëve, dhe pa shqetësime nga të tretët, për një periudhë të gjatë kohore, ka krijuar lidhje ekzistenciale me pronën e paluajtshme dhe pritshmëri, të cilat vlerësohen si proporcionale

⁹ Në fakt, Gjykata e zgjeroi mbrojtjen që parashikon neni 8 edhe për banuesen e një apartamenti në të cilin të drejtat e qirasë i kishte vetëm partneri i saj (*Prokopovich kundër Rusisë*, § 37; shih gjithashtu *Korelc kundër Sllovenisë*, § 82 dhe *Yevgeniy Zakharov kundër Rusisë*, § 32), dhe një personi që kishte jetuar në mënyrë të paligjshme në banesën e saj për gati 40 vjet (*Brežec kundër Kroacisë*, § 36).

¹⁰ GJEDNJ çështja *Selçuk dhe Asker kundër Turqisë*, § 86; *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], § 88; *Menteş dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 73

¹¹ GJEDNJ çështja *Aboufadda kundër Francës* (*dhjetor*)

¹² GJEDNJ, çështja *Keriman Tekin and Others v. Turkey*, §§ 40-43,

¹³ GJEDNJ, çështja *Saghinadze and Others v. Georgia*, §§ 104-108



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

lidhur me numrin e 27 viteve të jetuarit në të.¹⁴ Mgjth, në këtë rast, vlerësojmë se është kompetencë e autoriteteve gjyqësore që të vlerësojnë nëse autoriteti publik (IKMT) ka tejkaluar kufirin e tij të vlerësimit, i parë në raport me nenin 8 të KEDNJ-së.

➤ E drejta për strehim, si një objektiv thelbësor social

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka nënvizuar se e drejta për strehim të përshtatshëm nuk duhet të interpretohet ngushtë. Përkundrazi, duhet parë si e drejta për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet.

Plotësimi i nevojave të shtetasve për strehim është parashikuar edhe nga neni 59, gërma b) i Kushtetutës së RSH,. Kushtetutbërësi ka parashikuar se përmbushja e këtyre objektivave nga ana e shtetasve nuk mund të kërkohet drejtpërdrejtë në Gjykatë. Pra shteti shqiptar nuk ka detyrimin për realizimin e këtyre objektivave, por në çdo rast përmbushja e tyre varet nga mundësitë e disponueshme të shtetit (kryesisht mjetet financiare). Gjykata Kushtetuese në vendin tonë¹⁵ duke cituar vendimmarrjen e GJEDNJ-së në çështjen “*O’Rourke kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, ka argumentuar se “*çdo detyrim pozitiv i shtetit për të strehuar të pastrehët duhet të jetë i kufizuar*”.

Në rastin objekt monitorimi, duke qenë se ankuesja dhe familjarët e saj tashmë nuk kanë një banesë ku të jetojnë, në përputhje me nenin 31 të Kartës Sociale Europiane¹⁶ është detyrë e autoriteteve shtetërore që të marrin masat e menjëhershme dhe urgjente për të parandaluar numrin e personave të pastrehë, të nxisin aksesin në strehim për qytetarët si dhe të përshtasin çmimin e strehimit të arritshëm nga ata pa burime të mjaftueshme me synim të eliminimit gradual të këtij fenomeni.

✚ Konkluzione

- Referuar rastit objekt monitorimi, vëzhguesit konstatuan se pasuria e paluajtshme nuk rezulton të jetë regjistruar në pronësi të ankueses apo familjarëve të saj, ndërkohë që as veprime konkrete legalizimit të ndërtimit të realizuar mbi truallin nuk janë ndërmarrë, për shkak se këto objekte janë skualifikuar nga procedura e legalizimit pas kërkesës së depozituar nga ana e Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve, Jalë.
- Posedimi i vazhdueshëm i pronës nga ana e qytetares dhe familjarëve të saj në mënyrë të qetë dhe pa shqetësime nga të tretët për gati 27 vite, i ka vendosur ata në kushtet e mirëbesimit, i cili reflektohet edhe në tolerancën e dukshme të autoriteteve publike. Kjo ka sjellë krijimin e një lidhje ekzistenciale e periodike me pronën e paluajtshme.
- Referuar nenit 12 pika 5 e ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe pikës 4 të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i

¹⁴ Në përlogaritje mbahet në konsideratë viti 1993 kur është blerë prona për herë të parë nga pasardhësi i ankuesit, dhe viti 2020 kur është ndërmarrë aksioni i parë i prishjes së objektit.

¹⁵ Vendimi nr. 1/2013 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁶ Ratifikuar nga RSH në 2002 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2003 <https://ëëë.coe.int/en/ëëb/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=163>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”, konstatohet se nga ana e autoritetit publik IKMT nuk është respektuar detyrimi ligjor për vënien në dispozicion të qytetares të një kopjeje të procesverbalit të konstatimit, dhe as të kopjes së njehësuar të vendimmarrjes origjinale që mund të garantonte akses efektiv të ushtrimit të së drejtës së ankimit në gjykatën kompetente.

- IKMT nuk ka vendosur në dispozicion dhe nuk është provuar, që subjekti i kontrollit (qytetarja) të jetë njohur me procesverbalin e konstatimit dhe vendimmarrjen përkatëse, sipas procedurës së parashikuar nga pikat 6) dhe 7) të nenit 12 të ligjit 9780/2007.
- Në analizë të përmbajtjes së procesverbalit “Për konstatimin e kundërvajtjes nr. 08, datë 27.09.2021” dhe Vendimi nr. 210, datë 29.09.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, rezulton se këto akte administrative kanë një diferencë kohore prej dy ditësh nga njëra-tjetra. Në përputhje me ligjin nr. 9780/2007, procesverbali i konstatimit të kundërvajtjes është veprimi i parë që shoqërohet nga vendimmarrja përkatëse. Por duke qenë se në këtë procesverbal, vetë grupi i inspektimit ka reflektuar shënimin se subjekti juridik/fizik ku është kryer kontrolli është ‘i paidentifikuar’ dhe se subjekti/përfaqësuesi i tij prezent në momentin e konstatimit të kundërvajtjes është ‘i paidentifikuar’, autoriteti publik (IKMT) duhet të kishte ndjekur procedurën e afishimit të këtij procesverbal për një periudhë 5 ditore në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Vetëm pas ezaurimit të kësaj procedure, autoriteti publik (IKMT) duhet të dispononte me vendimmarrjen përkatëse për prishjen e objektit të paligjshëm.
- Parregullsia kundrejt respektimit të procedurave ligjore dhe mosnjohja e qytetares brenda afateve të arsyeshme me aktet përkatëse administrative, ka përbërë shkaqe për cënim të standarteve të aksesit në gjykatë dhe të drejtës për ankim efektiv, nën suazën e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe 6 i KEDNJ. Si rrjedhojë, qytetarja nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e ankimit të drejtpërdrejtë në Gjykatë brenda afatit 10 ditor, e drejtë kjo e garantuar nga neni 14 i ligjit nr. 9780/2007.

REKOMANDIME:

- **KShH i rekomandon IKMT-së marrjen e masave për shmangien e procedurave të paligjshme dhe të pambështetura në ligj, që kanë të bëjnë me prishjen e objekteve të paligjshme, aq më tepër kur ato përdoren për nevoja strehimi (banimi), si dhe të respektojë standartet e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të së drejtës për jetë private dhe familjare.**
- **Rekomandojmë gjithashtu garantimin nga inspektorët e IKMT-së të procedurës së njoftimit të akteve administrative ndaj qytetarëve, dhe respektimin e standarteve të provueshmërisë së procedurave të parashikuara në ligjin nr. 9780/2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.**
- **Në kuadër të varësisë së drejtpërdrejtë të IKMT-së, KShH i rekomandon Ministrisë së Brendshme¹⁷ marrjen e masave konkrete dhe të menjëhershme për**

¹⁷ VKM nr. 893, datë 4.11.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit” (i përditësuar).



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

verifikimin e procedurave të ndjekura nga ana e IKMT-së për banorët ankues të zonës së Jalës, si dhe marrjen e masave në përputhje me nenin 89 të Rregullores së Brendshme të IKMT-së.